

20160531342

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI HOTELIERE

### Neni 1

Në Ligjin për veprimtari hoteliere (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/2004, 89/2008, 115/10, 53/11, 141/12, 164/13, 187/13, 166/14, 199/14, 129/15 dhe 192/15) në nenin 4-a paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“Personat fizikë nga komunat, nga komunat në qytetin e Shkupit dhe nga qyteti i Shkupi, që e mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditë pune nga parashtrimi i kërkesës.”

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

“Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t’i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.”

Paragrafi 4 bëhet paragraf 5.

### Neni 2

Në nenin 4-v pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3 si vijon:

“Personat e autorizuar nga komuna, ndërsa në qytetin e Shkupit nga komunat në qytetin e Shkupit, i cili mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 alineja 1 të këtij neni, nga evidenca personale, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.”

Paragrafët 3 dhe 4 bëhen paragrafë 4 dhe 5.

Në paragrafin 5 i cili bëhet paragraf 6 fjalët: “paragrafi 3” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi 4”.

### Neni 3

Në nenin 19-v paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“Personi fizik nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë, që mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 i këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.”

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

“Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t’i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.”

Paragrafi 4 bëhet paragraf 5.

### Neni 4

Në nenin 21 pas paragrafit 1 shtohen tre paragrafë të rinj 2, 3 dhe 4 si vijojnë:

“Me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohet dokumentacioni në vijim:

1) aktvendim për regjistrim në regjistrin tregtar të lëshuar nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;

2) vendimi për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për kabare, klub të natës, disko-klub dhe disko-klube në hapësira të hapura, të miratuara nga këshilli i komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit, këshilli i komunës së qytetit të Shkupit;

3) fletëparaqitje për plotësimin e kushteve minimale-teknike për kryerjen veprimtarisë hoteliere;

4) me pëlqim prej organit të administratës shtetërore për punët nga sfera e punëve të brendshme për shkak se kushtet e plotësuara për mbrojtje të rendit publik dhe qetësisë dhe sigurisë të komunikacionit dhe

5) dëshmi për taksën administrative të paguara prej 50 denarësh.

“Personi zyrtar nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë, që udhëheq procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 pikat 1,2,3 dhe 4 nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.”

Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t’i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.”.

Paragrafët 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 bëhen paragraf 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

#### Neni 5

Në nenin 21-a fjalët: “ministri që udhëheq me” shlyhen.

#### Neni 6

Në nenin 21-b në paragrafin 1, fjala “ministri” zëvendësohet me fjalët: “organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e hotelerisë”.

#### Neni 7

Neni 22-a shlyhet.

#### Neni 8

Në nenin 29 paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“Personi fizik nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë, që e mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 pikat 1), 2), 5) dhe 7) të këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.”.

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

“Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 i këtij neni t’i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.”.

Paragrafi 4 bëhet paragraf 5.

#### Neni 9

Në nenin 53-g paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“Personi fizik nga organi i administratës shtetërore për punët nga sfera e hotelerisë, që mban procedurën, me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë nga paragrafi 2 i këtij neni, nga organi kompetent publik, në afat prej tri ditësh pune nga parashtrimi i kërkesës.”

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

“ Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 3 të këtij neni t’i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës. “

Paragrafi 4 bëhet paragraf 5.

#### Neni 10

Pas nenit 70-g shtohet nen i ri 70-d si vijon:

#### “Neni 70-d

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga komuna, ndërsa në qytetin e Shkupit në komunën e qytetit të Shkupit, nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afat të përcaktuar në nenet 4-a paragrafi 3 dhe 4-v paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjobë në shume prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga organi kompetent shtetëror për punët nga sfera e hotelerisë, nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afat të përcaktuar në nenet 19-v paragraf 3, 21 paragrafi 3, 29 paragrafi 3 dhe 53-g paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërshtim me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga organi kompetent publik nga i cili kërkohen dëshmitë nëse nuk dorëzon dëshmitë e kërkuara në afat të përcaktuar në nenet 4-a paragraf 4, 19-v paragrafi 4, 21 paragrafi 4, 29 paragrafi 4, dhe 53-g paragraf 4i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtare të autorizuar nga komuna, ndërsa në qytetin e Shkupit në komunën e qytetit të Shkupit, nëse nuk vendosë sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenet 4-b paragraf 1 dhe 4-v paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Komisionit nga neni 19-b i këtij ligji, nëse nuk vendosin sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 19-b paragraf 4 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtarë të autorizuar nga organi kompetent shtetëror për punët nga sfera e hotelërisë, nëse nuk vendosë sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 22 paragraf 1 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Komisionit nga neni 28 paragrafi 1 i këtij ligji, nëse nuk vendosin sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 28 paragraf 4 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Komisionit nga neni 53-v paragrafi 1 i këtij ligji, nëse nuk vendosin sipas kërkesës në afat të përcaktuar në nenin 53-v paragraf 4 i këtij ligji.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 i këtij neni, procedura për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

#### Neni 11

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të mbarojnë në pajtim me ligjin me të cilat ishin të filluara.

#### Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 124/15).